



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 133/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Muhamet Rexha dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes për Vetëvendosje (LVV) dega në Therandë, paraqitur kundër subjektit Nisma për Kosovën dega në Therandë, për shkak të vendosjes së posterëve, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 06.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Miratohet si e bazuar ankesa e Lëvizjes për Vetëvendosje (LVV), dega në Therandë kështu që Nismës për Kosovën, dega Therandë i shqiptohet dënimi me gjobë në lartësi prej 650 (gjashtëqind e pesëdhjet) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Arsyetim

Me datën 04.06.2014, Lëvizja për Vetëvendosje (LVV), ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën ankesë pretendon se, me datë 04.06.2014, në ora 10:30 aktivistët e LVV kanë vërejtur se në fshatin Shirokë – Komuna e Therandës, mbi një shenjë të komuniukacionit ishte vendosur poster i kandidatit për Kuvendin e Kosovës Haxhi Shala nga subjekti Nisma për Kosovën. Për këtë, në kuptim të dispozitës së nenit 4.1 pika (b) të Rregullës Zgjedhore të KQZ-së 11/2013 vendosja e posterëve mbi shenja të komunikacionit përbën veprim të ndaluar për subjektet politike, kandidatët dhe mbështetësit e tyre. Sipas kësaj, subjekti Nisma për Kosovën, me vendosjen e posterit (banerit) ka bërë shkelje të dispozitës së nenit 4.1 pika (b) të Rregullës Zgjedhore të KQZ-së 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2013.

Në cilësi të provës parashtruesi i ankesës ka ofruar një fotografi .

PZAP-i, më datën 05.06.2014, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi Nismën për Kosovën, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 06.06.2014 deri në ora 10:00.

PZAP-i, pranoi përgjigjen në ankesë sipas afatit të caktuar .

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e bazuar

Nga fotografia e ofruar si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se poster i kandidatit për Kuvendin e Kosovës Haxhi Shala nga subjekti politik Nisma

për Kosovën është vendosur mbi shenjë të komunikacionit në fshatin Shirokë, Komuna e Therandës, veprim ky i cili është në kundërshtim me dispozitën e nenit 33 pika (b) të LZP-së në të cilën përcaktohen veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, ku ndalohet vendosja e posterëve në shenjat publike të trafikut.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe

PZAP-i, mori parasysh rrethanat lehtësuese ngase subjekti në fjalë, pas marrjes së Kërkesës për dhënie të Përgjigjes në ankesë dhe Urdhërit për të Ndërmarr Masa Përmirësuese, ka ndërmarr veprime të dukshme për evitimin e shkeljes duke e larguar posterin nga vendi ku pretendohet se ka ndodhur shkelja e supozuar.

PZAP-i, duke marrë parasysh të gjitha arsyet e lartcekura konstatoi se subjekti NISMA për Kosovën ka rënë në kundërshtim me nenin 4 paragrafi 1 pika b) të Rregullës Zgjedhore Nr.11/2013 dhe nenin 33 pika b) të LZP-së, i cili nen parasheh se "Është e ndaluar vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve ose vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në apo mbi rrugët publike gjatë fushatës zgjedhore".

Duke marrë parasysh se subjekti NISMA për Kosovën pas pranimit të Kërkesës së PZAP-it për Përgjigje në ankesë dhe Urdhërit për të Ndërmarr Masat Përmirësuese, subjekti në fjalë menjëherë ka larguar posterat e theksuar në ankesë, që nënkupton se është bërë evitimi i shkeljes së supozuar në bazë të provave të cilat i ka ofruar të bashkangjitura në përgjigje në ankesë, e të cilat veprime kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar, si rrethana lehtësuese, andaj në kuptim të nenit 120 paragrafi 1 pika c), si dhe nenit 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 133/2014 më datën 06.06.2014.



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda një-etekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*